



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2023:048292

Datë: 27.06.2024

Numri i dokumentit: 05867909

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ - Departamenti i Përgjithshëm, divizioni penal, me gjyqtarin e vetëm gjykues Dardan Maloku, me zyrtaren ligjore Ardita Tasholli, në çështjen penale ndaj të pandehurit A.F. në Rr. "...", komuna Ferizaj, për shkak të veprës penale Rrezikim i trafikut publik nga neni 370 paragrafi 8 lidhur me paragrafin 1 të Kodit Nr. 06/L-074 Penal të Republikës së Kosovës (tani e tutje KPRK-së), sipas Aktakuzës të paraqitur nga Prokuroria Themelore në Ferizaj–Departamenti i Përgjithshëm, PP/II.nr.258/2023 të datës 04.04.2023, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor, të hapur për publikun, i cili është mbajtur më datë 06.06.2024, në të cilin morën pjesë prokurori i shtetit Dardan Çela, prokuror në Prokurorinë Themelore në Ferizaj, i pandehuri A.F. dhe mbrojtësi i tij me autorizim av Burim Krasniqi, pas pranimit të fajësisë nga ana e të pandehurit A.F., më datë 07.06.2024 mori dhe publikisht shpalli, kurse më datë 27.06.2024 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri

A.F. nga i ati I., e ëma E. e gjinisë P. i lindur më datë, në P.me vendbanim në Rr. "E.D.", komuna Ferizaj, me numër personal ka të kryer shkollën e mesme, me profesion shofer i martuar, baba i dy fëmijëve të mitur, i gjendjes së mesme, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

Ë S H T Ë F A J T O R

Sepse:

Me datën, rreth orës 17:30, në magjistralen F..P..., saktësisht në fshatin P.....nga pakujdesia shkel ligjin për trafikun publik, duke mos i'a përshtatur shpejtësinë e lëvizjes kushteve dhe rrethanave në rrugë me vendbanim, në atë mënyrë që duke drejtuar autobusin S...

S....shumëngjyrësh me targa-FP, me të arritur në fshatin P.M. në pjesën e parë të anës së djathtë të autobusit e godet këmbësorin tani të dëmtuarin F.J. i cili ishte duke e kaluar rrugën nga ana e djathtë në anën e majtë, ku pastaj këmbësori rrëzohet në skajin e rrugës në anën e djathtë të drejtimit të autobusit, me ç'rast i dëmtuari pëson lëndime të rënda trupore, të konstatuara nga ekspertiza mjeko - ligjore e dates 04.03.2023.

- Me këtë ka kryer veprën penale **Rrezikimi i trafikut publik** nga neni 370 paragrafi 8 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-së.

Andaj gjykata në bazë të neneve 4, 7, 8, 17, 21, 38, 42, 44, 69, 70, 370 paragrafi 8 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-së, si dhe neneve 364, 452, 455 paragrafi 1 dhe 462 të Kodit të Procedurës Penale (KPP-së), të pandehurin e :

G J Y K O N

- I. Dënim me burgim në kohëzgjatje prej 180 (njëqind e tetëdhjetë) ditë, i cili me pëlqimin e të pandehurit i zëvendësohet me dënim me gjobë në shumën prej 600 (gjashtëqind) euro, të cilën shumë i pandehuri është e obliguar ta paguaj brenda afatit prej 60 (gjashtë dhjetë ditësh) nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.
- II. Nëse i pandehuri nuk mundet apo nuk dëshiron ta paguajë dënimin me gjobë, të njëjtit në pajtim me nenin 43 paragrafi 3 të KPRK-së, dënimi me gjobë do të zëvendësohet me dënim me burgim, ashtu që për 20 (njëzetë) euro gjobë të papaguara, i pandehuri do të vuajë 1 (një) ditë burgim.
- III. I dëmtuari F.J. me vendbanim në fshatin P.M., komuna F....., për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest të rregullt juridiko – civil.
- IV. Obligohet i pandehuri në emër të shpenzimeve të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20 (njëzet) euro, në emër të shpenzimeve të procedurës penale-ekspertizën mjeko-ligjore shumë prej 20 (njëzet) euro, në emër të ekspertizës së komunikacionit shumë prej 150 (njëqind e pesëdhjetë) euro si dhe për fondin e kompensimit të viktimave të dhunës shumë prej 20 (njëzet) euro, andaj obligohet i pandehuri që në total lidhur me shpenzimet e procedurës penale ta paguaj shumën prej 210 (dyqind e dhjetë) euro, brenda afatit prej 30 (tridhjetë) ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

A R S Y E T I M

1.Rrjedha e çështjes dhe fjala përfundimtare e palëve

Prokuroria Themelore në Ferizaj - Departamenti i Përgjithshëm më datë 04.04.2023, ka ngritur aktakuzën PP.II.nr.258/2023, kundër të pandehurit A.F. për shkak të veprës penale Rreziki i Trafikut publik nga neni 370 paragrafi 8 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-së.

Me datë 06.06.2024, pranë kësaj gjykate është mbajtur seanca e shqyrtimit gjyqësor në të cilën ishin prezent prokurori i shtetit Dardan Çela, prokuror në Prokurorinë Themelore në Ferizaj, i pandehuri A.F. dhe mbrojtësi me autorizim av. Burim Krasniqi.

Në këtë seancë pas leximit të aktakuzës nga ana e prokurorit të shtetit, i pandehuri ka deklaruar se e ka kuptuar në tërësi aktakuzën dhe veprën penale për të cilën akuzohet dhe se e pranon fajësinë për kryerjen e veprës penale e cila i vihet në barrë andaj gjykata pas dëgjimit të palëve dhe në pajtim me nenin 322 paragrafi 1 të KPP-së, ka marrë aktvendim me të cilin ka aprovuar pranimin e fajësinë nga ana e të pandehurit.

Prokurori i shtetit në fjalën e tij përfundimtare deklaroi: pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar dhe atij gjyqësor është vërtetuar në tërësi gjendja faktike siç përshkruhet në dispozitivin e kësaj aktakuzë dhe atë nga provat si ne vijim: raporti i policit hetues i datës, deklarata e të pandehurit e dhënë në polici me datë dhe në prokurori me datë, deklarata e të dëmtuarit e dhënë në polici me datë raporti mjekësor i Qendrës Emergjente në Ferizaj me numër rendor, ekspertiza mjeko ligjore e datës ekspertiza e komunikacionit e datës fotografitë si dhe shkresat tjera që gjenden në lëndë. Në bazë të këtyre provave që janë administruar në shqyrtim gjyqësor është vërtetuar fajësia e të pandehurit dhe nuk ka asnjë rrethanë që e përjashton nga përgjegjësia penale, i propozoj gjykatës që të njëjtin ta shpall fajtor dhe ti shqiptoj një dënim sipas ligjit, po ashtu i njëjti të obligohet ti paguaj shpenzimet e procedurës penale, ndërsa me rastin e matjes dhe caktimit të dënimit në pajtim me nenin 69 dhe 70 të KPRK-së, si rrethanë lehtësuese i propozoj gjykatës që të ketë parasysh faktin se i pandehuri e ka pranuar fajësinë gjatë shqyrtimit gjyqësor, ndërsa si rrethanë rënduese të merr parasysh shkallën e lartë të rrezikut që ka ardhur për shkak të aksidentit ku është rrezikuar jeta e njeriut.

Mbrojtësi i të pandehurit në fjalën e tij përfundimtare ka deklaruar: meqenëse gjatë këtij shqyrtimi gjyqësor i pandehuri e ka pranuar fajësinë lidhur me këtë vepër penale, atëherë në fjalën përfundimtare do të paraqesim vetëm rrethanat lehtësuese të cilat shpresojmë që gjykata ti merr parasysh në matjen e dënimit, e të cilat janë pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurit në këtë fazë të procedurës, rrethanat e parapara me nenin 70 par.3 pika 3.1 të KPRK-së, ku në

bazë të ekspertizës të komunikacionit vet eksperti në përfundimin ekspertizës konstaton se në këtë rast me shkaktimin e këtij aksidenti në masë të madhe i kontribuon edhe i dëmtuari, po ashtu rrethana tjera lehtësuese gjykata të vlerësoj edhe faktin se i pandehuri ka qenë korrekt me sjellje e tij pas aksidentit, ku i njëjti është ndalur me mundësi të tij i ka ofruar ndihmën e parë, e ka njoftuar shërbimin emergjent, më pas familjarët e tij, prindi dhe vëllezërit kanë komunikuar me të dëmtuarit dhe i kanë ofruar ndihmë sa ka qenë duke u shëruar po ashtu vlen të ceket se të njëjtit i kanë porositur edhe barna speciale nga shteti i Gj..... për ta ndihmuar të dëmtuarin, po ashtu i pandehuri është penduar për veprimin që ka ndodhur nga pakujdesia e tij dhe premim që në të ardhmen do të jetë me i kujdesshëm në trafik, po ashtu si rrethana lehtësuese të vlerësoj edhe faktin se i pandehuri është familjar, mbajtës i familjes, prind i dy fëmijëve të mitur, andaj me rastin e matjes së dënimit i propozojmë gjykatës që ti shqiptoj një dënim sa më të butë dhe konform nenit 48 të KPRK-së ti shqiptoj një dënim me kusht pasi që besojmë se edhe me një dënim të tillë është në përputhje me qëllimin e dënimit dhe është mjaftueshëm për përmirësimin e të pandehurit, po ashtu japim pëlqimin që në rast se gjykata i shqipton dënim me burgim deri në 180 ditë të njëjtit t'ia zëvendësoj me dënim me gjobë dhe gjobën t'ia mundësoj t'ia paguaj me këste duke pasur parasysh gjendjen financiare.

I pandehuri A.F. në fjalën përfundimtare ka deklaruar se: e mbështes fjalën e mbrojtësit tim, jam penduar për këtë vepër, i kam kërkuar falje palës së dëmtuar dhe me të njëjtin kemi raporte të mira, është hera e parë që kam bërë aksident dhe jam shofer i autobusit qe 20 vite, unë jetoj me gruan time dhe me dy fëmijë dhe vetëm unë jam në marrëdhënie pune, jam mbajtës i familjes dhe ashtu siç theksoi avokati nëse gjykata më shqipton dënim me burgim deri në 6 muaj, jap pëlqimin që të më zëvendësohet me gjobë, mirëpo kërkoj nga gjykata që këtë gjobë të ma mundësoj ta paguaj me rata, kërkoj nga gjykata që të më shqiptoj një dënim sa më të butë.

2.Vlerësimi i pranimi të fajësisë

Gjykata pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor në të cilin kanë qenë prezentë palët e lartcekura dhe pas dëgjimit të palëve ka marrë aktvendim me të cilin ka aprovuar pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit për veprën penale për të cilën akuzohet ngase ka konstatuar se janë plotësuar gjitha kushtet ligjore të cilat kërkohen me nenin 242 paragrafi 2 të KPP-së dhe se pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurit nuk është kundërshtuar nga ana e palëve të cilat ishin prezentë.

Në këtë aspekt gjykata ka konstatuar se i pandehuri e ka kuptuar drejtë natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, se pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht nga ana e të pandehurit dhe i njëjti nuk ka qenë i detyruar ose i shtrënguar në asnjë mënyrë që të pranojë fajësinë. Pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes të cilat i përmban aktakuza siç janë: Deklarata e të pandehurit e dhënë në prokurori me datë 21.03.2023, Ekspertiza e Komunikacionit e përpiluar nga Eksperti i Komunikacionit Agon Kamenica e datës 14.03.2023, Ekspertiza Mjeko Ligjore me numër të referencës Fe-..... e datës 04.03.2023 e lëshuar nga Instituti i Mjekësis Ligjore Prishtinë, deklarata e të dëmtuarit F.J. e dhënë para zyrtarëve policor me datë 20.02.2023, Fletëlëshimi i lëshuar nga Qendra Klinike Universitare “QKUK” –Prishtinë me nr të amzës i datës 09.02.2023, Fletëlëshim me epikrizë me numër të amzës, Raporti Fillestar i Incidentit me numër e datës 21.01.2023, Raporti i Aksidentit me numër: i datës 21.01.2023, Raporti shtesë mbi aksidentin e trafikut rrugor me numër të rastit Raporti i policit hetues me numër të rastit ... i datës 21.01.2023, deklarata e të pandehurit Artan Fazlija e dhënë në Stacionin Policor në Ferizaj me datë 21.01.2023, Polica e Sigurimit me nr:.... e datës 24.06.2022, si dhe 3 (tre) fletë të formatit A4 me fotografi dhe shkresat e tjera që gjenden në lëndë, po ashtu me rastin e pranimit të fajësisë nga ana e të pandehurit gjykata gjeti se aktakuza lëndore nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

3.Gjendja faktike e vërtetuar

Duke u bazuar në të lartcekurat, gjykata vërtetoi këtë gjendje faktike: se i pandehuri Artan Fazlija, ka kryer veprën penale Rrezikim i trafikut publik nga neni 370 paragrafi 8 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-së, në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

4. Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit

Gjykata me rastin e matjes së dënimit ka vlerësuar që të pandehurit ti shqiptohet dënim me burgim në kohëzgjatje prej 180 (njëqind e tetëdhjetë) ditësh, i cili me pëlqimin e të pandehurit i zëvendësohet me dënim me gjobë në shumën prej 600 (gjashtë qind) euro, të cilën shumë i pandehuri është i obliguar ta paguaj në afat brenda 60 (gjashtëdhjetë ditësh) nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, ngase duke i marrë parasysh të gjitha rrethanat dhe provat të cilat gjinden në shkresat e lëndës, ky dënim do të jetë i drejtë, në harmoni me peshën e veprën penale dhe përgjegjësinë penale të kryesit dhe si i tillë me këtë dënim mund të arrihen qëllimet e dënimit në kuptim të nenit 38 të KPRK-ës. Gjithashtu gjykata me rastin e matjes së dënimit ka marrë për bazë edhe rrethanat që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit duke u

bazuar në nenet 69 dhe 70 të KPRK-së, ashtu që rrethanë lehtësuese për të pandehurin ka marrë: pranimin e fajësisë në shqyrtim gjyqësor, faktin se i njëjti është penduar për veprën penale që ka kryer, ka kërkuar falje publike, premtimin e tij që në të ardhmen nuk do të kryej vepra të tilla dhe as vepra të tjera penale, faktin se sipas ekspertizës së komunikacionit në masë të madhe me lëshime sekondare këtij aksidenti i ka kontribuar edhe këmbësori i moshës madhore F.J.– tani i dëmtuari, sjellën e të pandehurit pas kryerjes së veprës penale ku i njëjti është ndalur me mundësi të tij i ka ofruar ndihmën e parë, e ka njoftuar shërbimin emergjent si dhe është baba i dy fëmijëve të mitur dhe është mbajtës i familjes kurse rrethanë rënduese gjeti shkallën e dëmit të shkaktuar – ku të dëmtuarit i është shkaktuar pneumothoraks traumatik në të dy anët me hospitalizim dhe torakostomi në anën e majtë.

Gjykata konsideron se me dënimin e shqiptuar ndaj të pandehurit mund të arrihen qëllimet e dënimit të parapara në nenin 38 të KPRK-së e që konsistojnë në parandalimin e kryesit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij, të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

5. Vendimi lidhur më kërkesën pasurore juridike

Neni 462 paragrafi 2 i KPP-së përcakton se: *“Në aktgjykim me të cilin i akuzuari shpallet fajtor, gjykata mund të vendosë për kërkesën pasurore juridike të të dëmtuarit në tërësi ose pjesërisht dhe për pjesën e mbetur e udhëzon në kontest civil. Kur të dhënat e mbledhura në procedurë penale nuk paraqesin bazë të sigurt për gjykim të plotë e as të pjesërishtëm, gjykata e udhëzon të dëmtuarin që tërë kërkesën pasurore juridike mund ta realizojë në kontest civil apo të paraqes kërkesë në Programin për Kompensim të Viktimave nëse i plotëson kushtet e atij program”*. Andaj, pasi që nuk kishte një vlerë të saktë të kërkesës pasurore juridike dhe një veprim i tillë do ta zvarriste procedurën penale, gjykata duke u bazuar në dispozitën e lartcekur vendosi që të dëmtuarin për realizimin e kërkesës pasurore juridike ta udhëzoj në kontest të rregullt juridiko – civil si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

6. Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale

Duke pasur parasysh natyrën e kësaj çështje penale gjykata duke u bazuar në nenin 452 paragrafi 1 të KPP-së, ka vendosur që ta detyrojë të pandehurin që të paguaj paushallin gjyqësor në shumën prej 20 (njëzet) euro, si dhe duke u bazuar në nenin 36 paragrafi 3 nën paragrafi 3.1 të ligjit Nr. 08/L-109, për Kompensimin e Viktimave të Krimin shumën prej 20 (njëzet) Euro.

Nga Formulari për kompensimin e ekspertëve mjeko –ligjor i datës 28.02.2023, përcaktohen shpenzimet lidhur me ekspertizën mjeko – ligjore në vlerë prej 20 (njëzet) euro, andaj është detyruar i pandehuri që lidhur me këtë ekspertizë të paguaj shumën në vlerë prej 20 (njëzet) euro.

Nga formulari për kompensimin i shpenzimeve të ekspertëve, përkthyesve, vlerësuesve gjyqësor dhe profesionistëve tjerë i datës 14.03.2023 përcaktohen shpenzimet lidhur me ekspertizën e komunikacionit në vlerë prej 150 (njëqind e pesëdhjetë euro), andaj është i detyruar i pandehuri që lidhur me këtë ekspertizë të paguajë shumën në vlerë prej 150 (njëqind e pesëdhjetë euro).

Andaj duke u bazuar në të lartcekura gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ
Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal
2023:084535 me datë 27.06.2024

Zyrtarja Ligjore,
Ardita Tasholli

Gjyqtari i vetëm gjykues,
Dardan Maloku

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi mund të paraqitet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej 30 (tridhjetë) ditëve nga dita e pranimit të të njëjtit. Ankesa në kopje të mjaftueshme i paraqitet Gjykatës Themelore në Ferizaj.